



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

22-01-2024
02-20

	REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E SHITES/OPSTINA SHITLJE	
Nr i Prot/Bir Prot	02/87	
Nr i Faqeve/Bir.strana		
Data/Dana	22-01-2024	
SHITES-SHITLJE		

ANEKS I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

TË LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KOMUNËS SË SHITES

Në pajtim me nenin 7 të Memorandunit të Bashkëpunimit të lidhur me datë 30.09.2022 me numër protokolli në MKRS 4485/2022, në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Shtimes për projektin “Ndërtimi i Bibliotekës në Shtime” palët u pajtuan sa vijon:

Neni 1

Plotësim ndryshimi i Nenit 3, paragrafi 3.1

Plotësohet dhe ndryshohet Neni 3, paragrafi 3.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit merr përsipër të sigurojë buxhet shtesë prej 185,000 € për zbatimin e projektit “Ndërtimi i Bibliotekës në Shtime” brenda viteve të zbatimit si në Memorandum.

Neni 2

Plotësim ndryshim i Nenit 3

Plotësohet Neni 3, përkatësisht paragrafi 3.1, shtohet një paragraf i ri me numrin 3.1.6 me këtë tekst: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit merr për obligim të zhvilloj procedurat prokurimit për zbatimin e projektit për furnizimin me inventar të Bibliotekës në Shtime, sipas kërkesës së Komunës së Shtimes. Buxheti për këtë procedurë parashihet në buxhetin shtesë sipas Nenit 1 të këtij Aneks memorandumi.

Plotësohet Neni 3, shtohet një paragraf i ri me numrin 3.3 – Obligimet e përbashkëta. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komuna e Shtimes marrim përsipër të formojnë komisionin për pranimin dhe vendosjen e inventarit sipas projektit arkitektonik dhe procedurave nga pika 3.1.6 e këtij Aneks Memorandumi.

Neni 3

Pikat të cilat nuk janë plotësuar/ndryshuar me këtë aneks mbeten të pandryshuara.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky plotësim-ndryshim i Memorandunit të Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.



Hajrulla ÇEKU
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit



Qemajl ALIU
Kryetar i Komunës së Shtimes

Nënshkruar më 28/01/2024
Prishtinë